



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 dhjetor 2023, në mbledhjen e XIX-të (nëntëmbëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; *(Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Syla; Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli)* bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; *Bahri Selimi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH; Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Leutrim Krasniqi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM.*

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i ‘u dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, besoj se me rendin e ditës jeni të njoftuar sepse materiali ju është përcjellë me kohë, por para se të hedhet në votim rendi i ditës drejtori z.Bahri Selimi e ka një propozim të tij.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, dëshirojë të paraqes një pikë shtesë që të hyjë në seancën e së premtes. Fjala është për një Marrëveshje kornizë e bashkëpunimit ndër komunal, e cila është lidhur tash së fundi në mesë 6 Kryetarëve të Komunave përkatëse, Marrëveshje e cila ka të bëjë me disa fusha, pra janë të përfshira 8 fusha të ndryshme, dhe atë; mirëqenie sociale, shërbime publike, sport dhe kulturë, arsim, shëndetësi, siguri dhe emergjenca si dhe fusha tjera varësisht nevojave që mund të paraqiten në këtë bashkëpunim. Për këtë Marrëveshje është punuar që një kohë të gjatë dhe është bërë një bashkëpunim i ndërsjellë në të gjitha këto fusha që i ceka, prandaj kjo Marrëveshje kërkohet që të hyjë si pikë në seancë në mënyrë që të marrë pëlqimin e Kuvendit.

Materialin besojë që sot jua siguron zyra ligjore ku dhe do ta shihni për secilën fushë se çka parasheh ky bashkëpunim ndër komunal, pra kjo i paraprinë një projekti të madh i cili vjen në fushën e menaxhimit të mbeturinave ku është e cekur edhe këtu si fushë e veçantë një projekt i madhe i cili vije nga Banka Botërore për Zhvillim dhe GIZI Gjerman, prandaj e kemi obligim të dërgojmë për miratim në Kuvendin Komunal. pra para se t’ju shpërndahet ky dokument, ju informoj se Marrëveshja është e nënshkruar dhe protokolluar prej 6 Kryetarëve të Komunave fqinje, po ashtu e njëjta është e vulosur nga të gjithë dhe tani mbetet vetëm vendimi i Kuvendit për ta proceduar tutje.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk dua të krijojë dilema rreth arsyeshmërisë së një Marrëveshjeje ndër komunale, por krejt shkaku i procedurës mendoj i nderuar drejtor i DSHPMSH që të paktën ka qenë e nevojshme që sot para vetës ne si anëtarë të KPF-së ta kemi Marrëveshjen e cekur këtu si dokument të cilën e votojmë, mirëpo si do që të jetë, drejtori në fjalë theksoi që do të na pajisini me dokumentin e që faktikisht ka qenë dashtë që sot ta kemi këtu në tavolinë Marrëveshjen e cekur me qëllim që të dimë se çka

po votojmë. Nuk e kam asnjë dilemë sa i përket bashkëpunimit ndër komunal si e drejtë ligjore që është e përcaktuar edhe me të gjitha aktet normative që janë në fuqi dhe sigurisht që e mbështesim, por shkak i asaj që të paktën t'i kemi dokumentet që të dimë se çka po votojmë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, e kam të qartë dhe do të duhej të ishte ashtu siç e theksoj parafolësi z.Naim Çunaku, mirëpo ne po e kërkojmë vetëm që të futet në rend të ditës sot, kurse vendimi do të merret në seancën e Kuvendit. Pra do të pajiseni me material shumë shpejt, arsyeja përse nuk e keni momentalisht është se ka ardhur me vonesë dhe nuk kemi mund t'ju sjellim materialin me kohë, amdje pas nënshkrimit është dashtë të pritet edhe për një kohë sepse është kërkuar që e njëjta të nënshkruhet edhe në gjuhën serbe, andaj ka marr pak kohë dhe kanë qenë disa procedura që është dashtë të shkoj në 6 Komuna që të marrin nënshkrimet dhe vulat e Kryetareve të Komunave, kjo është arsyeja e vonesës.

Ne sot propozojmë që të hyj si pikë shtesë në rend të ditës, kurse sa i përket votimit nëse veç e mbështetni ju që duhet të votohet si Marrëveshje e cila është shumë e rëndësishme dhe që është punuar për një kohë të madhe nga Kryetarët të Komunave përkatëse. Është mirë që janë dakorduar të gjithë Kryetarët për të gjitha këto fusha ku unë kam qenë pjesë e Ekipës teknike që kemi diskutuar për këto çështje dhe ka pasur takime të shumta për këtë Marrëveshje, prandaj e kemi vlerësuar se është shumë e rëndësishme.

Pra kjo është vetëm për ta futur në rend të ditës nëse veç pajtoni që të hyj në rend të ditës, ndërsa për vendim shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, i nderuar drejtor i DSHPMSh, materiali është dashtë që të jetë sot këtu para anëtarëve të KPF-së në mënyrë që ta shqyrtojmë fillimisht këtu sepse ne si KPF vetëm sugjerojmë, ndërsa Kuvendi vendos për këtë Marrëveshje.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashtë të hyj në detaje, unë duhet ta di se çka po hyn në rend të ditës, në rregull po e konsiderojmë si lëshim nga ana e juaj, dhe e dimë që Marrëveshjet janë shumë të vlefshme e sidomos për Komunitat e vogla edhe pse ne nuk jemi Komunë e vogël, dhe atë në shumë segmente kur bashkëpunojnë me ato kapacitete të tyre që kanë, sidomos sa i përket aspekteve të menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave ku është një lehtësim e të tjera, për çka e kuptojmë dhe e mbështesim dhe nuk jam kundër përmbajtjes por nuk dëshirojmë që të bëhet praktikë që të votohet diçka pa e ditur se çka po votohet.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grup i LVV e përkrahim këtë Marrëveshje që të hyjë si pikë në rend të ditës, nëse z.Naim Çunaku ka ndonjë dilemë mund të pres rreth 10 minuta që të vijë dokumenti këtu në mënyrë që ta shohim dhe pastaj e diskutojmë.

z.Naim Çunaku, theksoi, e nderuara parafolëse, unë nuk kam hezitime sepse unë e dhashë mendimin tim por nëse juve si anëtare e KPF-së si një organ i ndërtuar nga Kuvendi i Komunës për harmonizimin e pikave që i sugjerohen Kuvendit e pranoni me kaq lehtësi, pa e ditur se për çka po voton, këtu ishte qëllimi e jo që unë nuk e përkrahi këtë Marrëveshje. E theksova më herët që do ta përkrahim, mirëpo si praktikë nuk është mirë të vazhdohet kështu ngase si anëtarë të KPF-së ne duhet t'i kemi dokumentet për të cilat votojmë.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, realisht në parim ne ishim të qartë se çka po votojmë sepse drejtori i DSHPMSh në pika të shkurtra e shpalosi Marrëveshjen se çka përmban. Kolegu ka të drejtë kur e thotë që duhet ta kemi dokumentin dhe që të mos bëhet si praktikë të mos sjellën materialet, mirëpo nuk ka diçka që të ketë hezitim në këtë çështje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë pajtohem me dy parafolësit, mirëpo është një lëshim teknik sepse drejtori i DSHPMSh ka pas mundësi që të përgatit materialin më herët dhe të bëjë shpërndarjen e tij.

Të gjithë jemi që kjo Marrëveshje të trajtohet në Kuvend Komunal.

z.Naim Çunaku, theksoi, fillimisht duhet të trajtohet si pikë në KPF e pastaj i rekomandohet apo jo Kuvendit për shqyrtim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marr fjalën atëherë e hedhim në votim që kjo pikë të hyj në rend të ditës në këtë mbledhje.

Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë:

- **Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndër-komunal Shumë-Funksional** (e lidhur mes 6 Komunave si në vijim: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit)

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, po ashtu edhe unë kam një çështje si propozim që të hyjë në rend të ditës, pikë që është miratuar më 27.09.2023 që është marrë vendim për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027, mirëpo në procedurat e vlerësimit të ligjshmërisë Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më 13.10.2023 e ka kthyer përgjigjen duke kërkuar rishqyrtim të vendimit me arsyetimin që në hyrje të vendimit nuk është përfshirë plotësim ndryshimi i Ligjit për mbeturina, e që nuk ka pasur plotësim ndryshim të dispozitave përkatëse të ligjit.

Pastaj me Ministrinë e cekur kemi pasur disa herë kontakte nëpërmes telefoni ku na kanë sugjeruar që në bazë ligjore të vendimit të figuroj edhe plotësim ndryshimi i ligjit edhe pse plotësim ndryshimi i ligjit nuk e prek nenet e këtij ligji bazë Për këtë jemi ankuar edhe me shkrim dhe kemi kërkuar që përgjigja e Ministrisë të përmirësohet dhe vlerësimi i vendimit të jetë në rregull sepse nenet përkatëse që i japin kompetencë dhe autorizim Kuvendit të Komunës që të miratojë aktet në fjalë nuk ka pasur plotësim ndryshim, mirëpo sërish MMPHI ka kthyer përgjigje duke kërkuar që plotësim ndryshimi i ligjit të ceket në vendim dhe në planin përkatës.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që dëgjova prej Kryesuesit, edhe pse sërish nuk jam shumë i qartë, por sipas asaj që e prezantuat ju do të thotë kemi të bëjmë me një gabim të pabazuar të Ministrisë, dhe atë vetëm pse është kompetencë e nivelit qendror për të shqyrtuar ligjshmërinë neve na fton që sërish të bëjmë rishqyrtimin e vendimit për miratimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave. Unë kështu kuptova dhe nëse është kështu vërtetë është për tu çuditur se si mundet një instancë që është e thirrur për shqyrtimin e ligjshmërisë, neve të na sjellë në këto situata, për mua është e pakuptimit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe për neve ka qenë e pakuptimte sepse disa herë e kemi kontaktuar MMPHI të cilët fillimisht kanë thënë që nuk na ka ardhur Plani, pastaj kur e kemi kontaktuar MAPL-në e cila ka thënë që e kanë dërguar planin, kështu që aty mes tyre ka pas mosmarrëveshje.

Unë isha në takim me përfaqësuesit e Ministrisë dhe më theksuan që patjetër duhet të bëhet rishqyrtimi i vendimit, pra të cekët edhe plotësim ndryshimi i ligjit në bazën ligjore edhe pse nuk ka pas ndonjë ndryshim në materie apo vërejtje në procedurë, por vetëm pse nuk është përmendur plotësim ndryshimi i ligjit në vendim dhe në plan.

z.Naim Çunaku, theksoi, nëse gjatë kohës kur është hartuar plani dhe ndërkohë kemi pasur ndryshim të ligjit atëherë kanë të drejtë sepse nuk është cekur plotësim ndryshimin e ligjit, të paktën të thirresh në plotësim ndryshim të ligjit, dhe nëse është kjo arsyeja nuk është faji te Ministria, por te ne.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, në fakt ligji ka pasur plotësim ndryshim, mirëpo plotësimi i ndryshimit të ligjit nuk e prek fare çështjen për të cilën trajtohet në planin e menaxhimit të mbeturinave prandaj nuk është cekur ai plotësim ndryshim i ligjit, por ata e kanë parë si të rrugës që të përmendet edhe plotësim ndryshimi i ligjit dhe kanë kërkuar rishqyrtimin e këtij vendimit.

Pra ne duhet ta rishqyrtojmë dhe vetëm të cekim në vendim dhe në plan edhe plotësim ndryshimin e ligjit për mbeturina, asgjë tjetër nuk ndryshon në atë plan.

z.Naim Çunaku, theksoi, me këtë që po e dëgjoj, Ministria kan të drejtë, arsyeja pse kanë të drejtë se është dashtë të cekët plotësim ndryshimi i ligjit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën e hedh në votim që kjo pikët të hyj si pikë shtesë e rendit të ditës në këtë mbledhje të KPF-së.

Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë edhe:

- **Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Podujevës** (përkatësisht përfshirja e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025)

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe 2 pikat shtesë të miratuara paraprakisht për përfshirje në kuadër të rendit të ditës.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më: 27 tetor 2023; 22 nëntor 2023; 06 dhjetor 2023.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse ndonjë prej juve nuk keni vërejtje për procesverbalet atëherë i hedhim në votim për miratimin e tyre.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohen procesverbalet nge mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa sipas kësaj pike të rendit të ditës.

2. Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, pra si propozim kemi vendimin për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Podujevës që planifikohen të japin në shfrytëzim për vitin 2024. Lista e veçantë është përpiluar dhe janë të përfshira pronat që janë në pronësi të Komunës së Podujevës, po ashtu e kemi edhe destinimin sipas Hartës Zonale që lejohet dhe që janë të paraqitura qoftë zonë bujqësore, pyjore apo ndërtime, prandaj kërkoj nga ana juaj që të përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV, e përkrahim këtë propozim vendim për miratim të listës së veçantë të pronave të paluajtshme. Konsideroj që është e rëndësishme dhe pozitive për arsyeje se hapen vende të reja pune dhe po ashtu krijon të hyra në buxhetin e Komunës së Podujevës.

Kemi afër 37 njësi kadastrale të cilat mendoj që janë në interes të qytetarëve që të përkrahët nga ne si Kuvend i Komunës, pra e përsëris se e përkrahim këtë propozim vendim dhe kërkojmë që të miratohet edhe në mbledhjen e Kuvendit Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me pikën që pronat komunale të jepen në shfrytëzim operatorëve ekonomik gjegjësisht atyre që kanë interes që të marrin ato prona në shfrytëzim, sigurisht që edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim, pa dashtë me përsërit atë që e theksoi parafolësi im ku njëra prej detyrave themelore të Kuvendit dhe Ekzekutivit është ruajta e pronës komunale.

Ajo ku kemi një dallim me z.Haki Rudarin është ngase prej fillimit të këtij mandati, madje edhe në mandatet tjera vazhdimisht kam kërkuar prej Ekzekutivit si organ kompetent që të gjitha pronat komunale të jenë në faqen e Komunës dhe të dihet se ku janë, në cilën gjendje janë, dhe kush i shfrytëzon ato, me të vetmin arsyetim që kjo do të bëjë më të përgjegjshëm.

Rast konkret është një realizimi i një projekti, zgjerimi i shtratit të lumit në fshatin Lluga dhe aty nëse del në teren sheh që njeriu që e ka pasur në shfrytëzim pa asnjë dokument me vite të tëra tani në një formë e ka bërë si pronë të vetën. Pra po të ishte lista e pronave komunale në të gjithë territorin e Komunës së Podujevës dhe nëse me një taksë simbolike të marrë komuna për shfrytëzimin e saj, ai person gjithmonë do ta kishte parasysh që ajo pronë nuk i përket atij, prandaj e them që ne si Komunë do ta kishim plotësuar standardin që e kemi për ruajtjen e pronës komunale sepse një pronë që merret në shfrytëzim i shtohet vlera e saj si dhe krijon të hyrat vetanake për Komunën.

E përkrahim këtë propozim, por do të donim që të jenë listat e pronave komunale, që të gjitha të paraqitura në faqen e Komunës, një gjë të tillë e kam kërkuar që nga viti 2007-2008, dhe është keq që për 20 vite Komuna mos t'i dijë pronat e veta. Pra kjo që po e theksoi nuk është e sodit, mirëpo nuk ecet përpara duke mbajtur kokën mbrapa, sepse sot është me lehtë që të bëhen publike ndërmjet digjitalizimit që është bërë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka në lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendi të ditës t'i rekomandohet Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare

(ndihmë në emër të kompensimit për fermerët e Komunës së Podujevës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjatë vitit 2022)

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, këtu sipas një arsytimi që e kam parë unë, këto dëme që janë shkaktuara në disa familje Ministria nuk i ka kompensuar dhe këto familje janë ankuar në Komunë, komuna e ka sjellë këtë listë që besojë që e keni para vetës, ku fermerëve nuk ju kanë paguar dëmet që në këtë listë janë afër 33 fermer. Në mungesë të përfaqësuesit së Drejtorisë përkatëse, fjalën i'a japim drejtorit të DPUMM.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, në emër të Ekzekutivit të Komunës e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, është e përcaktuar një ndihmë që është bërë në emër të fermerëve për shkak të fatkeqësive që kanë ndodhur gjatë vitit të kaluar dhe komisioni i formuar nga ana e Komunës ka bërë vlerësimin e tyre mirëpo në kuadër të kësaj nuk ka pasur mundësi që të bëhet kjo pagesë, kështu që propozoj që të votohet dhe të shkoj në Kuvend në mënyrë që të bëhet kompensimi i fermerëve me mjete financiare për dëmet e shkaktuara. Për më gjerësisht ndoshta do të ishte e nevojshme të ishte drejtori i Drejtorisë përkatëse, mirëpo meqë jam i përfshirë në proces ju informova rreth këtij procesi që ka ndodhur.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne si Grup i LVV në parim e përkrahim që të hyj si pikë e rendit të ditës, ndërsa vërejtjet sugjerimet dhe të gjitha kritikrat që i kemi i japim në Kuvend.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përket kësaj liste, ka qenë komisioni që e ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe me sa e kam kuptuar unë është vetëm lista e cila kompensimin e dëmit e bënë Ministria kështu që është përgjegjësi e komisionit sepse komisioni e ka bërë vlerësimin dhe këtu figurojnë disa shuma të mëdha andaj mendojë që është dashtë të bëhet një detajizim i shumave të mëdha. Pra e theksova këtë sepse është përgjegjësi e komisionit, jo për shkak të dy tre personave të mos sanksionohen 35 të tjerë.

z.Naim Çunaku, theksoi, atë që e dëgjova nga drejtori parafolës i DPUMM, pa dashtë të hyj në pjesën e vlerësimit sepse nuk është në pjesën e tij por që drejtorët të cilët është dashtë të jenë këtu siç është drejtori i DBF ashtu edhe ai i DBPZHR nuk janë këtu për t arsytuar këtë pikë, do e mbështesim që të kaloj në Kuvend. Vërtetë rreth këtyre listave që janë duke na ndodhur si Kuvend duhet të kemi kujdes sepse jemi duke hyrë në kompetenca të tjerëve sepse nuk është Kuvendi i Komunës që vendos për individin, pastaj Kuvendi nuk ka qenë pjesë e atij komisioni. Nuk mundemi nëse ndokush mendon që të bartë vendimmarrjen tek një organ kolektiv siç është Kuvendi dhe ti largohet përgjegjësive të tije dhe të atyre që

e kanë bërë atë punë. Po e përmbyll me fjalinë e parafolësit se është shumë e mundshme që 50% e tyre janë të arsyeshëm por me vetë faktin që janë refuzuar nga një instancë më e lartë, lë të kuptohen që gjithçka në rregull aty nuk është, mirëpo nga ajo që nuk i jap vetit të drejtë, dhe e marr shembull një thënie në drejtësi ku thuhet se më mirë 100 fajtor në liri se një i pafajshëm në burg, andaj duke u bazuar në këtë thënie unë do e mbështes këtë propozim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne e dimë që janë nënshkrimet e komisionit, ata e kanë përgjegjësinë dhe është dashtë të jepet nga ana e tyre arsytimi se pse është kthyer nga ana e Ministrisë, mirëpo siç e tha edhe z.Bashkim Sylja janë disa shuma të mëdha që për disa raste i kam edhe unë dilemat e mia, por prapë po e theksoi që përgjegjësinë e ka komisioni, përndryshe ndoshta ne jemi më shumë për me jap pëlqimin për këto mjete sepse për listë nuk kemi përgjegjësi.

z.Naim Çunaku, theksoi, me vetë faktin që ata e kanë paraparë që të kalojë përmes Kuvendit, është ikje nga përgjegjësia, pra është menduar që të miratohet vendimi në Kuvend dhe pastaj të thuhet se unë e kam ekzekutuar vendimin e Kuvendit.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, është normale që edhe komisioni e ka përgjegjësinë e vetë dhe nuk mund të them se që komisioni nuk ka fare përgjegjësi ngase në procesin e vlerësimit që është bërë si dhe verifikimit, për çdo humbje të shkaktuar është normale që komisioni e mban përgjegjësinë ndërsa Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi te pjesa e votimit, do të thotë kjo është e përcaktuar kështu.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DPUMM, jam i rezervuar për nesër dhe sot e ki mbështetjen për të kaluar në Kuvend, mirëpo nuk është ashtu drejtor, arsyeja ishte që komisioni e ka përgjegjësinë, pyetja është komisioni kujt i jep llogari dhe a e ka ngrit atë komision Kuvendi, pra nuk është ngrit nga Kuvendi, pra ai komision i jep llogari drejtorit të tyre si organ politik, kurse ne kur ndajmë mjete financiare emër për emër, atëherë ai komision amnistohet sepse është vendim i Kuvendit pastaj.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, edhe përkundër kësaj që u potencua nga parafolësi, komisioni nuk është që nuk ka përgjegjësi në këtë aspekt.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne nuk kemi ingerencë ndaj atij komisioni sepse nuk e kemi formuar ne si Kuvend, madje as llogari nuk na jep neve.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht kolegja e përmendi që në emër të Grupit të LVV e përkrahim që të rekomandohet për Kuvend dhe këtu pajtoj edhe unë plotësisht, por pajtoj edhe me kolegët tjerë.

Unë po lexoj disa çështje që janë shumë serioze, është refuzuar nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me arsytimin se janë bërë disa gabime teknike nga ana e fermerëve si paqartësi mungesë e fotografive e që është shumë serioze kjo dhe nëse mungesën e fotografive e ka refuzuar Ministria nuk e di se si ky komision na sjell neve në Kuvend që ne ta votojmë një diçka që nuk është në rregull ngase Ministria e ka konstatuar që nuk është në rregull. Pastaj thuhet mospërputhje të sipërfaqes që është dëmtuar në kultura të ndryshme bujqësore e që edhe kjo është serioze dhe është dashtë të analizohet.

Në fakt ne e përkrahim që kjo çështje të shkojë në Kuvend por mendoj që pavarësisht këtij komisioni ne kemi përgjegjësi si anëtar të Kuvendit dhe të mendojmë dhe të lexojmë se a të përkrahim a po jo për arsyeje se ka shumë paqartësi dhe janë shumë çështje që na vënë në lajthitje, madje në një mënyrë për që e ka refuzuar Ministria është diçka e pa qartë aty.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është mirë që drejtoresha e DBPZHR të na jap nesër informata më shumë rreth kësaj çështje, le të konsultohet me komisionin dhe Ministrinë dhe të na sjellë neve një material në mënyrë që ne të jemi të bindur që të votojmë këtë, përndryshe nuk ka bazë dhe fatkeqësisht po i dëmtojmë ata fermerë, vërtetë janë dëmtuar, mirëpo kjo është përgjegjësi e DBPZHR sepse në këto shuma të mëdha është dashtë që vetë së bashku me komisionin të bëjë vlerësimin.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, edhe pse nuk kam qenë i përfshirë në këtë proces e di që asnjë drejtor nuk ka qenë i përfshirë në këtë, por këtu është i përfshirë një komision i cili e ka bërë vlerësimin e të gjitha atyre dëmeve, komision i cili është i formuar në nivel të Komunës dhe nuk i takon asnjë Drejtorie, prandaj mendoj që drejtori ka mbet i pa informuar për këtë çështje.

Kryesuesi i komisionit është pjesë e DSHPMSh të cilën e udhëheqë unë dhe kemi komunikim të shpeshtë sa i përket këtyre dëmeve, andaj të mos përfshihen Drejtoritë tjera të cilat nuk janë të implikuara në këtë proces sepse komisioni është formuar nga Kryetari i Komunës kurse anëtarët e këtij komisioni janë pothuajse nga të gjitha Drejtoritë e Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë e mbështesë që të kalojë në Kuvend dhe aty diskutojmë më gjatë për këtë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në rregull është kjo sepse në këtë informatë nuk e patëm, pra kur të vie një pikë në rend të ditës të ketë së paku informata të sakta. Sa i përket listës në fjalë është përgjegjësi e komisionit, ne vetëm e votojmë atë listë të cilën e ka sjellë komisioni dhe unë personalisht do ta votoj sepse nuk dua që fermerët që vërtetë janë dëmtuar të mos përfitojnë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur shohim tabelën që na është ofruar si material aty janë të gjitha kulturat bujqësore dhe një që nuk ka qenë asnjëherë kulturë që u përmend më herët është kultura “abaz”.

Pastaj i nderuar z.Bashkim Sylja këtu thuhet vërshimet, ndërsa nga vërshimet nuk ka pas mundësi të preken të gjitha sepse nuk kanë qenë të gjitha për një kohë apo afat, këtu ka shumë dilema por do ta diskutojmë nesër në mbledhjen e Kuvendit.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, disa herë jemi ndërlidhë për këtë çështje, jo ka pasë jo nuk ka pasë vërshime në atë apo këtë kohë, gjë të cilën e kam sqaruar edhe një herë në Kuvend.

Komisioni nuk është i ngritur vetëm për vërshime por është komision i ngritur për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, pra nënkupton që nuk janë vetëm vërshimet fatkeqësi natyrore por është edhe breshëri, zjarret dhe të tjera, pra çdo dëm që është shkaktuar nga këto fatkeqësi natyrore ky komision është i obliguar të bëjë vlerësimin e tyre ndërsa kompensimi është çështje tjetër që i takon nivelit qendror dhe krahas këtij është edhe komisioni tjetër i formuar nga zyra e Kryeministrit, i cili vendos për kompensimin e tyre. Kjo çështje është kështu dhe absolutisht nuk ndryshon, më parë e kemi diskutuar që nuk ka pas vërshime dhe ju kanë dëmtuar personave të ndryshëm punishtet, nuk ka pasur vërshime por ka pasur breshër, mandej kemi edhe raste të tjera kur djegën shtëpitë nga flaka dhe bëjnë kërkesë për vlerësimin e dëmit.

Është edhe një çështje me rendësi, kur e kemi diskutuar disa herë që a t’i pranojmë apo jo këto kërkesa, thënë të drejtën nga qeveria i kanë theksuar komisionit që nuk keni nevojë t’i pranoni këto kërkesa që kanë kaluar afatin nga gjendje e jashtëzakonshme, por unë i kam thënë që ju si komision jeni të obliguar të pranoni çdo kërkesë që vjen në Komunë, bëhet vlerësimi i saj dhe nëse nuk është për neve si organ i kthejmë përgjigje që nuk është vlerësuar për këtë apo atë arsye, mirëpo pranimi i kërkesave duhet të bëhet në çdo rast. Tani kemi raste ku është djegur shtëpia, stalla dhe të tjera, vinë qytetarët bëjnë kërkesa për vlerësimin e dëmit por problemi është që ne nuk mund të bëjmë kompensim, përjashtimisht në këtë rast kur Komuna nëpërmes Kuvendit komunal t’ju ndan mjetet atyre që nuk kanë mundur të përfitojnë për shkak të mungesës së dokumentacionit apo që lëshimeve të bëra në nivel qendror.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk dua që të lëshohem në detaje dhe theksova që për këtë do të diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo për atë që po diskuton drejtori i DSHPMSh z.Bahri Selimi është e vërtetë që e ka thënë që ky komision nuk është veç për vërshime, shumë sakt, por kur e kemi pasur listën tjetër shkruante dëmet e shkaktuara nga vërshimet, kurse drejtori në fjalë thoshte nuk është vetëm nga vërshimet, kurse pikë të rendit të ditës formalisht ne e kishim dëmet nga vërshimet, andaj mendoj se duhet mësohem njëherë e mirë që çfarë shkruan aty duhet edhe t’i përmbahemi, madje kemi rastin që u përmend në fillim të kësaj mbledhje ku vetëm pse nuk është përmend edhe plotësim ndryshimin e ligjit në

një akt Ministria e ka kthyer, prandaj kur kemi të bëjmë me emërtime duhet të jemi të saktë (ngase nuk mund të jesh e abaz edhe kajtaz por vetëm njëri).

Sa i përket asaj se kush i paguan dëmet, u tha nga drejtori në fjalë por që e dim edhe ne se është kompetencë e nivelit qendrorë, e ceka se e dim edhe ne këtë sepse komuna jonë kur e ka bërë hartimin projekt buxhetit nuk ka ndarë vij buxhetore për fatkeqësitë natyrore, se po ta kishte të ndarë një pjesë fondit për fatkeqësitë natyrore do të ishte gjithçka në rregull, do ta kishte menaxhuar drejtori si dhe komisioni i jep llogari drejtorit, nëse bënë keqpërdorime ne si kuvendar do ta atakojm për keqpërdorime por në këtë kemi hyrë në krejt diçka tjetër, ku niveli qendror e ka refuzuar kurse ne duhet të kompensojmë, madje unë e di që subvencionet janë e drejtë e Kryetarit të Komunës si dhe ne e kemi kategorinë e subvencioneve, andaj cila është arsyeja që është sjellë në Kuvend.

Edhe njëherë e them se po dëshiroj të jem i rezervuar për nesër në mbledhjen e Kuvendit në mënyrë që të mos merremi sot m shumë për këtë temë, e që unë e potencova edhe më parë se e mbështesim të kalojë në Kuvend e që nga numri prej 36 personave që janë në këtë listë, nëse vetëm 2 prej tyre janë të vërtetë unë nuk mundem të votojë kundër, mirëpo duhet t'iu ndërpritet rruga "metrapazëve" të cilët janë duke e dëmtuar fermerin e vërtetë dhe këtë e them edhe duke marrë parasysh që në tabelën në fjalë në një rast shkruhet 0.62 ha e që unë këtë e kuptoj se janë 62 ari, ndërsa po të shikohet fermeri dalin 5 hektar bahçe, e unë pyes kush i ka në Llap 5 hektar bahçe, ne mund t'i mbyllim sytë por jo përtej kësaj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se diskutimet përfunduan për këtë pikë të rendit të ditës, andaj e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqenëse për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka të ljmëruar për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim që të rekomandohet Kuvendit për seancën e radhës që është caktuar të mbahet nesër.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit që raportimi në fjalë të bëhet në mbledhje e radhës të datës 28.12.2023

5. Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, ne vazhdimësinë e punëve të cilat janë kryer për Zonën Industriale në Podujevë pas tyre vjen edhe hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale. Objektivi kryesor i Planit Rregullues të Hollësishëm është përcaktimi i normave dhe i rregullave për të lehtësuar zhvillimin e Zonës sipas destinimit të përcaktuar në bazë të Hartës Zonale si dhe Planit Zhvillimor Komunal dhe janë gjithsej 61 hektar për të cilën duhet të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm. Dihet që funksioni i parë i Zonës Industriale është prodhimi prandaj edhe në bazë të hartimit të Planit Rregullues që do të bëhet në procedurat e më vonshme dhe si do t'i kushtohet këtij aspekti por gjithsesi edhe shfrytëzimet tjera të cilat janë në dobi të aktiviteteve dhe në funksion të prodhimit industrial. Një gjë është e rëndësishme të cekët që në kuadër të propozim vendimit që kemi bërë për Zonën Industriale janë disa parcela të cilat kanë mungesë të të dhënave grafike që janë në kadastër, dhe atë; parcela me nr.229-0 në fakt duhet të jenë parcelat me nr.229-2 dhe 229-3, pastaj parcela tjetër me

nr.230-0 në fakt duhet të jenë 230-2, 230-3 dhe 230-4, si dhe parcela me nr.293-0 duhet të jetë 293-1, 293-2 dhe 293-3, andaj edhe propozoj të ndryshohen.

z.Naim Çunaku, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim propozim vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm.

z.Bashkim Sylja, theksoi, e kam një pyetje për drejtorin e DPUMM, pasi që të përpilohet Plani Rregullues i Hollësishëm, a vie sërish për miratim në Kuvend sepse së pari nuk e di a është e arsyeshme që t'i jepet leje nga Kuvendi për të filluar procedurat.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, ne e kemi pas në diskutim këtë çështje ku është e paraparë me Hartën Zonale si Zonë Industriale, kështu që ne kemi diskutuar edhe me Zyrën ligjore për mundësitë e mos sjelljes së procedurave të dyfishta në Kuvend dhe që me këtë çështje të merret Ekzekutivi i Komunës, mirëpo pas diskutimeve që e kemi pasur edhe me Ministrin e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas tyre duhet të ndjekur të gjitha procedurat sikur se për Hartën Zonale, pra janë tri vendime të cilat duhet të nxjerrën nga Kuvendi i Komunës e që ky vendimi tani që po diskutojmë është vendimi i parë që është për iniciimin e procedurës, pastaj kemi vendimin e dytë që është për diskutimin publik, si dhe vendimi i tretë është për miratimin final në Kuvendin e Komunës.

E rëndësishme është se Plani Rregullues i Hollësishëm është i nevojshëm ligjërisht për shkak të përcaktimit dhe investimeve që do të bëhet në bashkëpunim me Ministrin e Ekonomisë dhe pjesa tjetër që është e nevojshme të cekët është që pas shpronësimit Komuna do ta parasheh një pjesë të zhvillimit aty dhe normal që do të vjen edhe pjesa tjetër për të gjitha ato prona që janë në emër të Komunës, pastaj nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë vjen lista dhe do të jepen në shfrytëzim për të interesuarit apo për investitorët. Normale që është një procedurë kohore më e gjatë por po besojmë që brenda vitit të ardhshëm do të përfundojë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, faleminderit për sqarimet e dhëna nga Drejtori i DPUMM, unë dilemën kryesore e kisha se ky Plan në fund a do të vije për miratim në Kuvend e që drejtori në fjalë i shpjegoi procedurat deri në përfundim të këtij procesi, kështu që ne e përkrahim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në seancën e radhës të caktuar për nesër.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

6. Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal

- Raporti nga konsultimi publik

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, Plani Operativ Emergjent Lokal ka dalë njëherë në Kuvend kur është kërkuar dëgjimi publik, kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe tani po kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që të miratohet ky plan në mënyrë që të bëhet funksional. Se çka përfshin ky Plan dhe çka i ndihmon Komunës do t'i diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grup i LVV e përkrahim draft Planin Operativ Emergjent Lokal, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i japim në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për seancën e radhës e caktuar për nesër.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

7. Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndër komunal Shumë-Funakisonal

(e lidhur mes 6 Komunave dhe atë: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqi)

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë për këtë pikë u diskutua në fillim të mbledhjes kur edhe u propozua dhe u dha arsytimi që të hyjë pikë shtesë në këtë mbledhje, konsideroj se nuk kemi diçka çfarë të shtojmë më shumë edhe për faktin se tani më ju është shpërndarë materiali dhe keni mund ta shikoni, mirëpo urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që të rekomandohet Kuvendit për përfshirje në rend të ditës dhe shqyrtim seancën e radhës të caktuar për ditën e nesërme.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit të thirrur për datën 28.12.2023

8. Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Podujevës

(përkatësisht përfshirja e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025)

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit u dhanë sqarimet në fillim të mbledhjes, mirëpo urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim që të rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në seancën e radhës të caktuar për ditën e nesërme..

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për rishqyrtim sipas kërkesës së MMPHI, konkretisht për përfshirjen e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2025, kurse pjesët tjera të Planit mbeten të pandryshuara nga dokumenti i miratuar më 27.09.2023.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Procesverbalin e mbajtën;

Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0090172/23

Podujevë,

27 dhjetor 2023

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha